

UNITED NATIONS



NATIONS UNIES AT

INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL  
FOR THE FORMER YUGOSLAVIA

TRIBUNAL PÉNAL INTERNATIONAL  
POUR L'EX-YOUGOSLAVIE

CHURCHILLPLEIN 1, P.O. BOX 13888  
2501 EW THE HAGUE, THE NETHERLANDS  
TELEPHONE: +31 70 416 5326  
FAX: +31 70 416 5307

CHURCHILLPLEIN 1, B.P. 13888  
2501 EW LA HAYE, PAYS-BAS  
TELEPHONE: +31 70 416 5326  
FAX: +31 70 416 5307

*Lënda Nr. IT-04-84-R77.4*  
*Prokurori kundër Bajrush Morinës*

*PUBLIK*

**VENDIM**

**ZËVENDËSSEKRETARI,**

**DUKE MARRË SHËNIM** Statutin e Tribunalit të miratuar nga Këshilli i Sigurimit në bazë të Rezolutës 827 (1993), dhe në veçanti Nenin 21 të tij;

**DUKE MARRË SHËNIM** Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Tribunali më 11 shkurt 1994, dhe me ndryshime të mëvonshme ("Rregullorja"), dhe në veçanti Rregullat 44, 45 dhe 77 të saj;

**DUKE MARRË SHËNIM** Direktivën për Emërimin e Avokatëve të Mbrojtjes të miratuar prej Tribunalit më 28 korrik 1994, me ndryshime të mëvonshme ("Direktiva") dhe në veçanti Nenet 14(A) dhe 16 të saj;

**DUKE MARRË SHËNIM** Kodin e Sjelljes Profesionale për Avokatët që Dalin Para Tribunalit Ndërkombëtar (IT/125 REV.2);

**DUKE MARRË SHËNIM** se më 8 janar 2008 u dorëzua një aktakuzë kundër Z. Bajrush Morina ("I Akuzuari") ku ai akuzohet për shpërfillje të Tribunalit sipas Rregullës 77 të Rregullores dhe se aktakuza u bë publike më 25 prill 2008;

**DUKE MARRË PARASYSH** se i Akuzuari u transferua në selinë e Tribunalit më 28 prill 2008 dhe se paraqitja e tij e parë u krye më 29 prill 2008;

**DUKE MARRË SHËNIM** se Rregullat nga kapitulli 4 deri në kapitullin 8 zbatohen *mutatis mutandis* në lidhje me procedura që mbulohen prej Rregullës 77 të Rregullores;

**DUKE MARRË PARASYSH** se më 29 prill 2008 Z. Jens Dieckmann, avokat nga Gjermania, u caktuar “avokat kujdestar” për të Akuzuarin, për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të të Akuzuarit deri kur ai të marrë avokat të përhershëm ose t’i caktohet avokat sipas Rregullës 45 të Rregullores;

**DUKE MARRË PARASYSH** se I Akuzuari ka bërë të ditur se do t’i bëjë kërkesë për ndihmë ligjore Tribunalit bazuar në Nenin 8 të Direktivës, me arsyetimin se ai nuk ka mjete financiare për shpërblimin e avokatit dhe i ka kërkuar Sekretarisë që ta emërojë Z. Jens Dieckmann si avokat të përhershëm të tij;

**DUKE MARRË PARASYSH** se Sekretaria nuk ka përcaktuar ende nëse I Akuzuari është në gjendje të shpërblejë avokatin ose masën e shpërblimit;

**DUKE MARRË PARASYSH** se në përputhje me Nenin 11(B) të Direktivës, Sekretari mund t’i caktojë të akuzuarit avokat për një periudhë prej 120 ditësh për të garantuar mosçënimin e të drejtës së të Akuzuarit për avokat gjatë kohës që Sekretaria shqyrton mundësinë e tij financiare për shpërblimin e avokatit;

**DUKE MARRË PARASYSH** se në këtë rast është e nevojshme që të Akuzuarit t’i caktohet avokat sipas Nenit 11(B) për të garantuar mosçënimin e të drejtës së të Akuzuarit për avokat gjatë kohës që Sekretaria shqyrton mundësinë e tij financiare për shpërblimin e avokatit;

**DUKE MARRË SHËNIM** se aktualisht Z. Dieckmann është caktuar bashkavokat në çështjen kundër Z. Sredoje Lukiq në *Prokurori kundër Milan Lukiqit dhe të tjerëve*;

**DUKE MARRË PARASYSH** se Sekretaria ka qartësuar se nuk ekziston konflikt interesash midis përfaqësimit të Z. Lukiq prej Z. Dieckmann dhe përfaqësimit të të Akuzuarit prej tij;

**DUKE MARRË PARASYSH** se Sekretaria ka përcaktuar se përfaqësimi prej Z. Dieckmann për Z. Lukiq dhe të Akuzuarin nuk do të dëmtojë qoftë mbrojtjen e Z. Lukiq, qoftë mbrojtjen e të Akuzuarit, kryesisht për shkak të shtrirjes së kufizuar të çështjeve që trajtohen prej Rregullës 77 të Rregullores;

**DUKE MARRË PARASYSH** se si Z. Lukiq po ashtu dhe I Akuzuari kanë dhënë pëlqim me shkrim për përfaqësimin e dyfishtë prej Z. Dieckmann pasi morën këshillë të pavarur ligjore në lidhje me këtë pikë prej Sekretarisë, bazuar në Nenin 16(G) të Direktivës;

**VENDOS** ta emërojë Z. Dieckmann si avokat të të Akuzuarit për një periudhë 120 ditëshe bazuar në Nenin 11(B) të Direktivës, në fuqi që prej datës së këtij vendimi.

/nënshkrim/  
John Hocking  
Zëvendëssekretar

Sot më 20 maj 2008  
Në Hagë  
Holandë